

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Turqia shton presionin ndaj organizatave LGBTQ+, mbi 150 të ndaluar në protestën e Stambollit
ADRESA	https://www.gazetatema.net/bota/turqia-shton-presionin-ndaj-organizatave-lgbtq-mbi-150-t-e-ndaluar-ne-protes-i586283
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	redirected

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 13:59:35 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 14:45:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	15f951828480f3446563eaff9c81b0e119f310d9d31403ad2f3671b7adcd97d2
TEKSTI	86b99f094781486f32adae93117a3828f368c2f295b94700925a77c15c6dab2a
PAMJA	eb391251b6c570a90786357debc2fa154dd4cbe032b71f8687e9faf230f33114

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	c6665396e3cf99ffb344ae31957076e03fbef91f2a23194c348864abdc9bd55
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	30dbb60d3d02cfc881d14f9729132b5faa86f341ad579020b2892f9612d800a7
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/c6665396e3cf99ffb344ae31957076e03fbef91f2a23194c348864abdc9bd55>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



ie [Frika nga AfD, kishat ne Saksoni-Anhalt nisin zhvendosjen e emigranteve ne rajone te tjera te Gjermanise](#)[Soni Malaj 'ndez' rrjetin nga pushimet, shfaqet ne super forme](#)
fundit

Turqia shton presionin ndaj organizatave LGBTQ+, mbi 150 të ndaluar në protestën e Stambollit



15 Shtator 2026, 16:45Bota TEMA



Policia turke ndaloi të paktën 150 persona pas ndërhyrjes në një protestë të mbajtur para Gjykatës Caglayan në Stamboll, ku pjesëmarrësit ishin mbledhur për të shprehur kundërshtimin ndaj arrestimeve të fundit të aktivistëve LGBTQ+.

Sipas Reuters, protestuesit synonin të jepnin një deklaratë për mediat, por u penguan nga policia. Gjatë ndërhyrjes ata brohoritën: “Rroftë jeta pavarësisht urrejtjes”.

Protesta u zhvillua pas kontrolleve të gjera ndaj organizatave LGBTQ+ në disa provinca të Turqisë. Qeveria e ka justifikuar operacionin, të quajtur “Familja ime është e sigurt”, me argumentin se synon mbrojtjen e fëmijëve dhe të vlerave familjare.

Gjatë fundjavës, autoritetet ndaluan të paktën 26 persona në Stamboll dhe 21 në Ankara, ndërsa kontrolluan zyrat e disa organizatave LGBTQ+. Një gjykatë turke vendosi të dëlën masën e paraburgimit për 16 persona në provincën perëndimore të Izmirit, sipas prokurorisë lokale.

Ministri turk i Drejtësisë, Akin Gurlek, deklaroi se hetimet, të koordinuara nga prokuroritë në Stamboll, Ankara, Izmir, Aydin dhe Mersin, përfshijnë 162 të dyshuar, nëntë shoqata dhe 13 kompani në 15 provinca.

Autoritetet kanë bllokuar gjithashtu aksesin në faqe interneti dhe profile në rrjetet sociale të organizatave LGBTQ+, individëve dhe disa mediave të pavarura, përfshirë llogarinë në X të degës turke të Amnesty International.

Lidhur me zhvillimet reagoi edhe Komisioneri për të Drejtat e Njeriut i Këshillit të Europës, Michael O’Flaherty, i cili shprehu shqetësim për arrestimet, kontrollet dhe kufizimet në internet ndaj organizatave të shoqërisë civile dhe aktivistëve LGBTQ+. Ai theksoi se mbrojtja e vlerave familjare ose e fëmijëve nuk mund të përdoret si justifikim për kufizimin e të drejtave të njeriut dhe bëri thirrje për lirimin e të gjithë personave të ndaluar për aktivitetin e tyre në shoqërinë civile ose në fushën e të drejtave të njeriut.

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Frika nga AfD, kishat në Saksoni-Anhalt nisin zhvendosjen e emigrantëve në rajone të tjera të Gjermanisë](#)

15:55 Bota

Rritja e frikshme e AfD-së/ Pse demokracia gjermane s'mund të mbrohet më nga ekstremizmi?

15:35 Bota

[Makina përplasët me këmbësorët dhe dy automjete, dy të vdekur dhe katër të plagosur rëndë në Britani](#)

14:05 Bota / 2 komente

[Dyshohet për sabotim/ Kaos në hekurudhat e Holandës, anulohet qarkullimi i trenave](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.